

REPubLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 27.11.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugëve lokale në fshatin Korishë, me elemente të betonit, me sistem të participimit, mori këtë

### KON KL U Z I O N


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 25.11.2013, për lejimin e ndërtimit të rrugëve lokale në fshatin Korishë, me elemente të betonit, me participim, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Maja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-52647  
Më 4.12.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Maqedoni dhe pagesës së mëditjeve për Bajram Bashën dhe Sherife Çengajn, zyrtarë komunale, kryetari i Komunës, më 4 dhjetor 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Lejohet udhëtimi zyrtar i Bajram Bashës dhe Sherife Çengajt, zyrtarë komunale, për në Ohër të Maqedonisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorin (vizitë studimore) që organizohet në kuadër të realizimit të projektit “Rruga gastronomike” i cili projekt është i Komisionit Evropian. Punëtorja (vizitë studimore) do të organizohet nga data 4 dhjetor deri me 6 dhjetor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurit.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. Dr. Ramadan Vllahi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-52643  
Më 4.12.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Belgjikë dhe pagesës së mëditjeve për Përparim Shalën, zyrtar komunale, kryetari i Komunës, më 4 dhjetor 2013, miratoi këtë:

## VENDIM

### Neni 1

Lejohet udhëtimi zyrtar i Përparim Shalës, zyrtar komunale, për në Bruksel të Belgjikës, me qëllim të pjesëmarrjes në vizitë studimore që ka të bëjë me studimin e mobilitetit për trafikun urban, që organizohet nga data 8 dhjetor deri me 12 dhjetor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
dr. Ramadan Mija

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 4.12.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejinim e shpalljes së tenderit për furnizim me dhurata për Vitin e Ri 2014, mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejinim e furnizimit me dhurata për Vitin e Ri 2014, për punëtorët e Komunës së Prizrenit, dhe për fëmijët me nevoja të veçanta në tërë territorin e Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 9.12.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material ndërtimor për rregullimin e shtëpisë së djegur të Salajdin Hoxhës nga Prizreni, mori këtë:

### KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e furnizimit me material ndërtimor për rregullimin (meremetimin) e shtëpisë së djegur të Salajdin Hoxhës nga Prizreni, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatës.

Furnizimi me material ndërtimor do të bëhet deri në vlerën 10.000 €.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-54696

Më 11.12.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare të Shoqatës “Alternatif D”, kryetari i Komunës, më 11 dhjetor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit, i datës 10.12.2013, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare të Shoqatës “Alternatif D”, e cila vepron në kuadër të Shoqatës së Shkrimtarëve Turq të Kosovës, për organizimin e manifestimit: “Takimet e 6-ta tradicionale të kulturës dhe poezisë në Kosovë, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 11.12.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me komposterë, mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e furnizimit me komposterë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për furnizim me 500 komposterë.

Ky projekt është i paraparë në Rregulloren për Menaxhimin e mbeturinave të ngurta në Komunën e Prizrenit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "Kryetari i Komunës", "Prof. dr. Ramadan Muja", and "PRIZREN". A handwritten signature in black ink is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 11.12.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e programit kompjuterik (softuerit) i cili do të shërbej për nevojat e Sektorit për Menaxhimin e mbeturinave, mori këtë:

### KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e realizimit të programit kompjuterik (softuerit) faza e I-rë, që do të shërbej për nevojat e Sektorit për Menaxhimin e mbeturinave, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Ky projekt është i paraparë në Rregulloren për Menaxhimin e mbeturinave të ngurta në Komunën e Prizrenit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 11.12.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e projektit për ngritjen e vetëdijesimit për menaxhimin e mbeturinave të ngurta, mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve, për lejimin e realizimit të projektit që ka të bëjë me ngritjen e vetëdijesimit për menaxhimin e mbeturinave të ngurta në Komunën e Prizrenit, përkatësisht për realizimin videove (spoteve), broshurave dhe reklamave të ndryshme, kështu që për realizimin e këtij projekti lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Ky projekt është i paraparë në Rregulloren për Menaxhimin e mbeturinave të ngurta në Komunën e Prizrenit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. Dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-zyrtar

Më 10.12.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të dhuratave për mysafirët dhe të koktelit me rastin e përmbylljes së vitit kalendarik 2013, kryetari i Komunës, më 10 dhjetor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të dhuratave për mysafirët (fletore me logo të KK, lapsa, kalendar, etj) dhe koktelit të organizuar nga ana e kryetarit të Komunës, me rastin e përmbylljes së vitit kalendarik 2013, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare.

Mjetet lejohen pas parashtrimit të faturave dhe për të njëjtat të përpilohet raport me shkrim.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-55784  
Më 12.12.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës për formimin e Komisionit për regjistrim të inventarit dhe pajisjeve të tjera - pronë komunale për vitin 2013, kryetari i Komunës, më 12 dhjetor 2013, miratoi këtë:

## AKTVENDIM

**I.** Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës rreth formimit të Komisionit për regjistrimin dhe evidentimin e mjeteve themelore-inventarit dhe pajisjeve të tjera në të gjitha objektet e Komunës së Prizrenit për vitin 2013. Për anëtarë të këtij komisioni, emërohen: 1. Naim Kukaj, kryetar, 2. Sherife Çengaj, 3. Ylber Gashi, 4. Gylaj Gështenja, 5. Sefer Avduti, 6. Hava Berisha, 7. Alban Hamzaj, 8. Merita Besimi, 9. Azem Bilibani, 10. Fail Hoxha, 11. Galip Belallari dhe 12. Halifat Karahoda, anëtarë. Komisioni i lartcekur duhet të mbështetet edhe nga shërbimi i furnizimit të KK-së.

**II.** Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi do të bëjë regjistrimin dhe evidentimin e inventarit në këto objekte: Objekti i Ekzekutivit të KK-së, objekti i ndërtesës së Kuvendit të Komunës, zyrat e Drejtorisë së Arsimit dhe të Shkencës, të Drejtorisë së Ekonomisë dhe të Financave, zyrat e gjendjes civile dhe objektet e tjera që menaxhohen nga Kuvendi i Komunës.


**III.** Ky Komision, për punën e bërë, do të raportojë me shkrim para organeve kompetente të Komunës së Prizrenit.

**IV.** Puna e komisionit llogaritet si punë jashtë orarit të rregullt të punës dhe se për punën e bërë, anëtarët e Komisionit do të kompensohen nga ana e KK-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Administratës dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria e Administratës, të emëruarit dhe Arkivi.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-55787  
Më 12.12.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të parashtruar nga Drejtoria e Administratës rreth formimit të Komisionit për vlerësimin e pasurive komunale për vitin 2013, kryetari i Komunës, më 12 dhjetor 2013, miratoi këtë:

## A K T V E N D I M

**I.** Miratohet propozimi i parashtruar nga Drejtoria e Administratës rreth formimit të Komisionit për vlerësimin e pasurive komunale për vitin 2013.

Për anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

1. Alban Susuri, kryetar,
2. Fejsal Hoti, dhe
3. Shyhrete Kovaq, anëtarë.

**II.** Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika I e këtij Aktvendimi do të jenë ato që janë paraparë me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 21/2009 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare.

**III.** Ky Komision, për punën e bërë do të raportojë me shkrim para organeve kompetente të Komunës së Prizrenit.

**IV.** Pas raportimit me shkrim për punën e bërë, anëtarët e Komisionit do të kompensohen nga KK-ja, dhe se puna e komisionit llogaritet si punë jashtë orarit të rregullt të punës.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Administratës dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria e Administratës, të emëruarit dhe Arkivi.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-56858  
Më 12.12.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të emitimit të spotit televiziv “Enjoy Prizren”, kryetari i Komunës më 12 dhjetor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të emitimit të spotit televiziv “Enjoy Prizren” (Mirë se vini në Prizren) që ka të bëjë me promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Prizrenit. Kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të pagesës së këtij emitimi të spotit nga disa televizione lokale në Prizren, lejohen mjetet financiare në shumën prej 600 €.

Ky spot televiziv do të emetohet nga televizionet lokale në prag të viti të ri 2014.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, Drejtorit tjera komunale, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-zyrtar

Më 12.12.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.12.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për lejimin e shpalljes së tenderit për shitjen e masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, dhe mori këtë

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për lejimin tenderimit të masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, kështu që lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e 40 m<sup>3</sup> dru të llojit ah dhe bung, me çmim fillestar prej 25 € për 1 m<sup>3</sup>.

Shitja do të bëhet sipas specifikacionit të prezantuar të drejtorisë përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-56860

Më 12.12.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Nënkyetarit të Komunës, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Serbi dhe pagesës së mëditjeve për Ramadan Tafallarin dhe Shpresa Osmanollaj, zyrtarë komunal, kryetari i Komunës, më 12 dhjetor 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Nënkyetarit të Komunës, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Ramadan Tafallarit dhe Shpresa Osmanollaj, zyrtarë komunal, për në Beograd të Republikës së Serbisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë që ka të bëjë me realizimin e projektit: “Rrjetëzimi lokal për zhvill të qëndrueshëm”. Punëtorja do të mbahen nga data 13 dhjetor deri me 15 dhjetor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurit.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Nënkyetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Nënkyetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

